

INTERVISTË ME MYRVETE LIMANIN

Prishtinë | 3 qeshor 2015

Kohëzgjatja: 104 minuta

Të pranishëm:

1. Myrvete Limani (E intervistuar)
2. Jeta Rexha (Intervistuesja)
3. Lura Limani (Intervistuesja)
4. Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja/Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Jeta Rexha: Zoja Myrvet', a mundeni me na tregu për fëmininë tuj'? Çfarë fminije keni pasë, çfarë fmije keni qenë dhe krejt çka mbani n'mend?

Myrvete Limani: Natyrisht mund t'ia filloj prej asej. Mund t'ju thom' prej fillimit, si familje, si fëmi, si familje n'tanësi ndaj fëmive edhe marrëdhanieve familjare, me plot gojë edhe me plot zemër ju them qi kemi pasë jetë t'shkëlqyshme. Jo vetëm unë, por edhe motrat edhe vëllaznit. Për arsye se familja jonë ka qenë familje me antarë t'familjes të mëdhaja ashtu si kanë qenë përpara. Kom pasë dy prindërit, kom pasë vëllazënit dy të mëdhenj, mandej një motër, natyrisht ma e madhja. Edhe, në t'vërtetë unë jam motra e tretë ma e vogla e shpisë, por mas meje kanë ardhë edhe dy vllazën kshtu qi shpija jonë, familja jonë ka qenë e madhe – babë e nonë, katër vllazën e tri motra. Me ju thonë t'drejtën nuk ma merr menja qi ka ekzistuar, tash nuk muj me hi... familje ma e pajtushme se ne. Kte e them bash për atë se kurrë nuk kemi pasë pengesa prej prindërve me dalë me shëtitë, interesimi i tyne ka qenë që ne t'shkollohemi që ta rujmë edukatën. Atëherë n'ato kohna mbi gjithçka, ka qenë vleftë e madhe edukata familjare. Kshtu që n'atë pikëpamje, krejt popullata e Gjakovës mundet me folë dhe me ditë familjen tonë, shpija e Halim Hoxhës.

E në t'vërtetë unë kom pasë edhe gjyshin edhe babën, n'kohën e Turqisë gjyshi ka kry shkollat ma t'nalta turke. E dini që këto vende kanë qenë t'okupume pesë qind vjet, prandaj gjyshi jonë ka qenë shumë i nderumë dhe i afirmumë edhe ka qenë drejtor i medresës t'shkollës t'naltë... si me thanë fetare, e n'Gjakovë i përmendin. Krejt... në t'vërtetë gjyshin nuk e njoh se s'kemi pasë atëhere fotografi nuk ka pasë. Por, ka metë në historinë e gjyshit tem krejt tregimi, veçanërisht për ne që s'e kemi pasë ashtu. Kur ka vdekë ai, i osht' pëcjellje e posaçme n'Gjakovë për arsye se ai ka qenë kryetar i fesë t'Gjakovës, i shkollum', i arsimum' n'kohën e Turqisë n'skollat ma t'nalta edhe drejtor i medresës.

Mund t'ju them edhe kte, e vetmja gja që ne... m'kujtohet mu si fmi, kemi pasë n'shpi raftat. Ajo shpija jonë ka qenë një shpi e stilit turk. Ato shpija turke n'formë t'shpisë tonë që kemi pasë te baba n'Gjakovë, i kom pa n'Stamboll kur kom shku' ma vonë. Domethonë, ka qenë e qasaj kohe. Edhe krejt raftat kanë qenë me libra t'trasha dhe t'forta që ato jonë punu. Edhe baba jem, tash djali i gjyshit, edhe ai e ka kry shkollën turke, e ai ma vonë osht' bo edhe mësus, ka dhonë mësim n'Gjakovë shkollave fetare, për arsye

se shkolla tjera nuk ka pasë. Atëhere s'ka pasë shkolla tjera. Na kemi qenë nën Turqi, n'Turqi ka qenë krejt punë asi... atëherë kanë qenë shumë të nderumë... e lashë pak n'gjysë.

Çka ka mbetë... kur na ka vdekë gjyshi, tregojshin, krejt Gjakova osht' çu tashti, dojnë me vorrosë. Mirëpo aty kanë qenë rivale si duket edhe kjo feja muslimane e hoxhëve edhe e shelerëve. Unë s'di me i spjegju, vetëm që asishne, gjysën e përcjelljes së kufomës e kanë bo hoxhallarët, qysh shkon xhemoti, e gjysën tjetër patjetër osht' dashtë me bo kjo sekta e bektashinjëve a s'di si thirret, mos m'kapni fort se nuk i di ato gjana (qeshë). Edhe, ka qenë i vendosun vorri i tij m'u shpallë tyrbe. Tyrbja e tijna, kur t'bojsh me hi n'Gjakovë, n'hymjen n'fillim osht' ni teqe e madhe bash majtas si t'hijsh, aty ku ndahet në rrugë, hin mrena n'Gjakovë edhe majtas, aty e ka pasë tyrben, por vorri i tij ka qenë tybe i shpallun profet si tyrbe. Nuk ka leju me hi mrena, ka thonë vorrin tim du me ma lonë n'skej, du me m'ra shiu.

Domethonë kjo osht' një histori të cilën na e kemi ndigju, e kemi ndigju veçanërisht këta vëllaznit e mij. Fadili ka qenë shumë ma i interesumë se une e kom pasë edhe një vëlla ma t'madh se Fadili, po ai ka qenë ma tepër i interesumë për këto historina që nuk kanë metë si dorëshkrime për shembull çka ka ndodhë n'atë kohë. Noshta ka nëpër ato, asi... por në familje sa na ka spjegju edhe krejt Gjakova e din këtë punë. Kështu që, ka qenë i nderumë shumë – Haxhi Emin Efendiu, Emin emnin. Vllau jem e ka pasë emnin e gjyshit e ai vlla m'ka vdekë tash shumë shpejt. Emin... edhe ai e kish pasë emnin Emin. Kjo osht' qaq sa kom dijeni për afërsisht.

Lura Limani: Ti vet je konë n'shkollë në shqip a po?

Myrvete Limani: Ah?

Lura Limani: Ti vet je konë n'shkollë në shqip, nuk ki shku n'shkollë fetare?

Myrvete Limani: Eh tash për shkollën teme po ju kallxoj (qeshë). Ne atëhere s'kemi pasë shkolla, edhe fillumë me u rritë. Une e kom pasë një motër pak ma t'madhe se une, nja dy-tri vjet qashtu, une ma e vogla. Edhe tash na kapë valavama me shku n'shkollë. Kanë qenë n'gjuhën serbishte klasët e para, po na n'serbisht gjakovarët s'kemi shku' kurrë. Edhe kurrë s'e kemi msu gjuhën serbe... a din mirë s'e kemi msu.

Edhe tash çka me bo, na çoi baba... edhe n'atë kohë n'Gjakovë kanë qenë, nuk e di çka ju thomë atyne. Familjet private hapshin shkolla me msu për fe, lutjet fetare qato. Edhe une me motrën teme... këto kanë qenë private, për shembull naj shpi e ka hapë ato, i merrke gjashtë fëmi i pagujshin dhe anëtari i familjes i cili e ka pasë atë t'drejtën dhe dijeninë, na msojke për gjana fetare. Mirëpo ajo, kur kemi shku une e motra edhe e di edhe shpinë e maj n'mend edhe ato, msusin plak e maj n'mend, nuk kemi nejtë shumë për arsye se fillunë me u hapë do klasë t'para gatimore n'gjuhën serbishte. E këta prindët e tonë, a jonë serbishte a jonë çka jonë veç me mujtë me hi n'shkollë edhe m'u orientu dikah. Kështu që n'fillim, para se me fillu shkolla n'gjuhën shqipe me ardhjen e okupitmit të Italisë edhe Gjermanisë n'Kosovë kemi shku edhe serbisht. Kemi shku, nuk e maj n'mend a kemi nejtë një vjet ose dy. Si me thonë si këto grupet e çerdheve qashtu, për afërsisht qajo moshë ka qenë e jemja, veçanërisht ajo motra jeme tri vjet ma e

madhe se unë ka qenë, unë kom qenë shumë ma e vogël. Kshtu që m'sillen në kujtime, kjo... por ajo mandej nuk na zgjati shumë falë Zotit.

Se e okupunë Gjermania dhe Italia pjesën e Ballkanit, Lufta e Dytë Botënore ishte n'proces gradualisht, edhe kuptohet atëherë u hapën shkollat edhe kemi hi edhe une, edhe motra në t'njetën klasë n'gjuhën shqipe. Kështu që, prej asaj kohe kemi fillu me asi... mësusë nuk ka pasë! Mësusë erdhën prej Shipnisë. Kanë ardhë mësusët t'thirrur... ata kanë qenë mësusët e parë barëm i maj n'mend do emna t'asaj kohe t'atyne mësusëve, kështu që prej asaj kohe ka fillu mas ardhjes së okupimit të Italisë, kanë fillu shkollat, klasa e parë si me thonë n'gjuhën shqipe. Dhe deri n'atë kohë, ose n'shollë fetare kanë shku edhe rinia, edhe asi... ose kanë nejtë n'shpi, nuk ka pasë...

Por prindët tonë kanë qenë t'interesumë, diku prej fëminisë t'hershme me na çu diku n'shollë, edhe ne kemi shku n'shollat fetare, ato u thirrshin mejtepe, kanë qenë t'karakterit privat. Si me ardhë dhetë vetë qitu, edhe me msu e me u kthy. I mësunë lutjet t'ndryshme fetare, edhe nuk e maj n'mend sa kemi nejtë, e mbaj n'mend që shumë pak kemi nejtë. Menihere u banë ndryshime, edhe mandej kemi shku n'shollë edhe natyrisht mandej shkolla ka fillu me marrë n'gjuhën shqipe krahë. Ka qenë kijamet! Situata ka qenë, ma s'pari nën Turqinë, sa vjet kanë asi... turqisht kanë msu, po kto serbisht kanë qenë ma t'tmerrshme për popullin musliman edhe për popullin shqiptar.

Mirëpo atëherë, kush ka kqyrë, veç me shku në ni shkollë e me mujtë asi... Kur fillojnë shkolla shqipe atëherë fillojmë me i hapë sytë edhe duhet me falemnderu Shqipninë e cila menihere i ka çu mësusët. I çonte një here dy, një here ashtu, u krijojshin klasët. Kuptohet me dy-tri klasë të një rangut, dy-tri klasë në rangun tjetër, mandej mo murrë hov, e kur murrë hov nuk osht nalë mo.

Edhe një ndryshim ka këtu, atëhere kanë qenë shkollat, si me thanë shkollat fillore e nuk mund t'them që kanë qenë shkolla t'mesme t'kuptimit t'plotë. Me ardhjen dhe fitoren e partizanëve, po mendoj me fitimin e luftës nacional çlirimtare, atëherë krejt Kosova ka fillu me marrë frymë prej ktyne klasëve që po flas tash e që po m'duken edhe mu thu se s'po flas diçka t'sigurtë, kemi mbri në akademi në shkolla. Qe ku e kemi rininë, qe ku e kemi shkencën, qe ku e kemi akademikët e shumë suksese tjera.

Lufta nacional çlirimtare shumë dobi i ka sjellë Kosovës, shumë dobi. Kosova ka qenë mund t'them lirisht territori noshta ma i prapambetun n'këtë... Ballkan. Kuptohet atëhere qato shkolla fetare kanë qenë mandej n'gjuhën turqishte, nuk e di funksionet e tyne por tu u nisë prej familjes tonë, ata kanë qenë njerëz pa... që i kanë kry shkollat t'nalta turke.

Kaltrina Krasniqi: A ju kujtohet Lufta e Dytë Botnore?

Myrvete Limani: M'falni?

Kaltrina Krasniqi: A ju kujtohet Lufta e Dytë Botnore? Çka mbani n'mend prej Luftës t'Dytë Botnore?

Myrvete Limani: Çka mbaj n'mend, për çka për luftën?

Kaltrina Krasniqi: Për Luftën e Dytë Botnore?

Myrvete Limani: Për Luftën e Dytë Botnore maj n'mend gjithçka. Pse po thom gjithçka, pse prej fëminisë së hershme, lufta kur ka fillu kam qenë e re, nuk e di moshën mund t'them tetë-nantë vjet qashtu. Edhe mandej ky... këta vëllaznit e mi, të mëdhenjtë Fadili edhe Fahria, këta kanë qenë. Fahria ka qenë ma i madh se Fadili, ata shumë kanë qenë t'interesumë për shkolla. Edhe serbisht kanë shku me msu, që rrallë shkojke dikush serbisht. Gjakovarët mo hiç, hiç s'kanë ditë serbishte, s'kanë dashtë kurrë me msu edhe ashtu. Mirëpo, ata shumë kanë qenë t'interesumë me kry shkollat, n'gjuhën serbishte kanë shku.

Fadili mandej, se vëllau i madh, tash na kemi qenë... baba fillon me u plakë, çështja ekonomike megjithëse prejardhjen e kom prej, tash po m'bijka pak me u lavdu, prej një familje shumë t'pasun t'Gjakovës. Po mendoj me pasuni tokësore, me kësi... Baba jonë ka qenë edhe tregtar, osht' marrë me shitjen, tregtar i tekstilit qysh i thojnë. Nuk e di tash qysh i thojnë. Mirëpo, këta vëllaznit e madh e kanë pasë për detyrë se na kemi qenë tjerët tonë t'vogjëli, kështu që këta dy vëllaznit Fadili dhe Fahria, Fahria ka qenë shumë pak ma i vjetër se Fadili e atëhere jeta osht' përcjellë edhe në kujdesin e tyne. Mirëpo Fadili mandej ka pasë tjera dëshira, gjithsesi me mrrri n'shkollë me u shkollu, edhe obligimin familjar ma pak, se babën e kemi pasë edhe t'ri edhe ka qenë komunikativ e ka qenë i aftë. Ai ikë prej Kosovës prej Gjakovës po mendoj, unë jam gjakovare edhe kufini ka qenë i mbyllun, shumë i rrezikumë, del n'Shipni. Me daljen e tij n'Shipni, n'kufinin me peripeti shumë t'mëdhaja dhe t'randa, atëhere regjistrohet në Shkollën Normale t'Elbasanit, aty shkollohet, edhe aty e merr atë hovin si me thanë t'butovnikut¹, revolucionarit për me mujtë me e çliru këtë popull prej urredhëve.

Se, Serbia ka qenë shumë e keqe ndaj nesh, shumë ka qenë e keqe. Veçanërisht krejt, po flas për atë kohë edhe sigurisht edhe në vendet tjera kështu, shumë kanë bo shtypje n'popullatë, veçanërisht me poreze [tatime]. Atëhere konkretisht me marrë familjen tonë, na kemi qenë shumë t'pasun e dijnë tonë gjakovarët mirëpo nuk ke pasë pare t'gatshme sikur tash e ki rrogën edhe ke obligim financiar me ia siguru pushtetit ato çka i ki borxh. Atëhere nuk kanë mujtë fort. Kështu që kasapët kryesorë, që e kanë torturu popullin, kanë qenë porezgjitë ata që kanë ardhë me marrë tatimet nëpër shpija. Edhe kur s'ke qenë n'gjendje me ia pagu paret, ka mbledhë disa sende t'shpisë për me t'kushtu patjetër për me shku me marrë ato m'i pagu paret, obligimet e porezit që jonë në familje.

Kjo osht' një shprehje për të cilën nashta po ndini hera e parë, po qështu kur strujën nuk je n'gjendje me pagu, ujin me pagu, qëto jonë obligimet shtetnore po mendoj. E porezgjii u thirrshin ata, kanë pasë për detyrë me ardhë n'familje, "S'pi pagun paret? Qikaq ki metë borxh!" Merrshin teshat, merrshin sendet e atëherë s'kishe qare pa i gjetë ato pare me shku me pagu me i kthy gjanat që t'i kanë marrë. Ajo ka qenë ma e ronda n'Gjakovë. Për vende tjera s'muj me folë, por natyrisht n'Kosovë n'tonësi qashtu ka qenë.

¹ Serb.: Rebel.

Pjesa e Dytë

Kaltrina Krasniqi: A ju kujtohet kur kanë kanë ardhë italianët n’Gjakovë, okupimi italian?

Myrvete Limani: M’kujtohet. Na si fmi, erdhën, dulëm me pa rrugës, del prej shpisë e po vijnë italianët. Ata vijshin ushtarakisht, nuk kanë ardhë kështu. Kalojshin nëpër qendër edhe i zijshin pozicionet, kanë qenë s’bashku me gjermanët, atëhere kanë hy edhe e kanë kriju shtetin e tyne. Por për ne, ajo s’ka qenë ukupues por çlirimtare për ne. Edhe një pjesë e popullit si osht’ zakon, kur t’kalon ushtria a diçka që e ki pasë shpresë, gjithmonë e pret me kangë e me gëzim, megjithëqë na e kemi ditë qi jonë okupues, populli i Gjakovës. Prandej edhe ka fillu mandej m’u shfaqë lëvizje me fillu luftat prej italianëve dhe gjermanëve se ata kanë qenë okupues. Dhe ata mandej me shtetin e tyne e kanë kry ato misionin e patjetër osht’ dashtë me organizu diçka.

E një ndër ta, rinia e Gjakovës ka qenë si me thanë t’etshëm për liri, t’rijë, me pasë sportin e organizumë, me pasë punën e ku ta di unë. Interesant ka qenë një rini shumë e madhe atëhere n’Gjakovë, si fëmi e maj n’mend. Edhe ata t’rritun kanë shpërthy e ashtu. Mandej, realisht lufta ka fillu prej Gjakovës, lufta ka fillu. Nuk po e thom’ asi por kjo masa e rinisë gjakovare edhe familjet të cilat kanë marrë pjesë, për këtë luftë e kanë përhapë n’Kosovë. Ju e dini se Fadili ka qenë edhe komandant i përgjithshëm, atëherë mas tij ka shku një pjesë e madhe e popullatës. Një luftë shumë e pastër, shumë e drejtë edhe ka metë ashtu e drejtë, po tash po lypin e kërkun s’osht’ mo ajo. Nuk osht’...

Lufta u bo, edhe masnej u bo, po frymëmarrjen e kemi mas marimit t’Luftës t’Dytë Botnore, mas fitimit që kanë bo partizanët. Kte mund t’ju thojnë edhe prindët e ju, se u bonë edhe dy-tri lufta mandej. E kuptohet n’lufta mandej na Kosova nuk e fitoi lirinë krejt, Kosova apat met nër serbët, e dini. Ajo ka qenë apat dhimbje e madhe, por nër serbë e ki edhe sot Kosovën. Pjesën veriore ku e ki? Serbët, Evropa po t’i cakton, po t’i jep. Kështu që ky popull i Kosovës po vunë gjithmonë. Mandej tash që o’ ma kijamet, edhe prej vendasve që pi keqpërdorin, ka vujtje. Ju i keni prindët, e i keni t’gjithë ishalla jonë t’knaqun.

Lura Limani: T’kthehemi pak n’kohë, me na tregu qysh edhe Fadili edhe Fahrija kanë dalë n’Shqipni me u eduku a po? N’cilin vit kanë shku?

Myrvete Limani: Për me dalë, Fadili ka dalë.

Lura Limani: Aha, okej.

Myrvete Limani: Fadili ka dalë i pari, ai ka dalë msheftas e ka tregu historiatin qysh e kalu kufinin, shumë vështirë. Mandej kufinin shumë rini e Gjakovës e ka kalu. Një pjesë e rinisë ka metë n’kufi, as familjet e tyne nuk e kanë ditë n’kohën e Zogut, n’kohën e Italisë. Shumë ka qenë vështirë, Fadili ka arritë me shpëtu, mirëpo ai regjistrohët n’shkollë, ai s’ka pasë t’drejta me hy n’Kosovë edhe m’kujtohet kur thojsin prindët e mi baba dhe nana, “Do t’shkojmë me taku’ Fadilin”, edhe s’kanë mujtë m’u taku afër me bo muhabet, po njëni n’kufi anej, tjetri knej prej s’largti kanë bo muhabet edhe e kanë pa njëni tjetrin. Me fitimin e

luftës, po mendoj fillunë me u hapë kufijtë. Tash edhe Kosova hinën italianët. Me hymjen e saj, u bashku kjo, në t'vërtetë kishe jemi t'bashkumë me Shipninë, por qeverinë s'e kemi pasë ashtu.

Edhe Fahria vllau i madh prej Fadilit, edhe ky vllau tjetër Sania, Sani e ka pasë emrin, kanë shku atje me punu veçanërisht tash me ikë se e njëkshin Fadilin me nixonë. Mandej na kanë... edhe familjen tonë na kanë torturu, por osht' shumë interesant, une kur hi edhe tash mendoj n'gjitha kohnat e kemi pasë babën shumë t'durushëm, shumë t'qëndrushëm edhe e ka përshëndetë këtë luftë. Ka vujtë shumë edhe e ai mandej familja jonë ka vujtë shumë për arsye se kemi qenë t'njekun ashtu, edhe dy vllaznit Fahrija e Sania kanë shku n'Tiranë me punu.

Ata punojshin atje, Fahria osht' detyru me marrë pjesë në çetat partizane, mirëpo për shkak tonin, na kemi qenë hala një familje me fmi hala t'parritun. Ai osht' kthy prej ushtrisë patizane, shkon n'Tiranë me Saninë edhe atje e zonë ato, e burgosin, se n'Kosovë kemi pasë shpijuna shumë. Shpijuna jonë njerëzit të cilët i hijjnë n'shërbim armikut, e një ndër ta shpijunat ma t'njoftun që i ka majtë n'men Gjakova ka qenë Ali Bokshi edhe ka qenë ky... tash m'kujtohet emni (qeshë), moment... ma vonë noshta e plotësoj. Shpijuna ka pasë, kanë hy n'shërbim t'okupatorit... Beqir Malokun, ata kanë qenë shërbysit kryesorë.

Kështu që Ali Bokshi, Ali Bokshi tash një shpiun që e njëj edhe fmija n'djep prej Gjakovës, e kemi pasë si me thonë njeri t'mahallës. Si me thonë, dhetë shpi ma larg, ai n'shërbim aty. Edhe, me 3 prill po m'duket i '43-shit, i hyjnë edhe i kallin krejt Gjakovën. Ma s'pari kallet shpija jonë, sulmohet shpija jonë. Me sulmin e shpisë tonë, se po ju thom kojshitë si me thonë kojshia i katërt qitu n'mahallë, qështu e kemi pasë Ali Bokshin. Kanë fillu rafalet asishne, kemi qenë qaty n'sobë, jemi përgatitë me rra, bu bu bu. Vllau i madh, i thotë baba atij, "Fahri, largohu!" Na s'kemi bo kurgjo, po rrijmë n'shpi, a din kur... Edhe ai ka qenë, babën bajegi n'moshë e kem pasë, natyrisht ka qenë n'moshë. Nuk m'kujtohet vjetët. Ai largohet, nona edhe baba rrijnë, neve na qesin te kojshitë, "Dilni ju aty se na e dijmë që shpija jonë osht' n'be me asi". Ata rrijnë n'shpi, nona me babën rrijnë n'shpi.

Na dalim te kojshitë si me thonë qitu te kojshitë {tregon me dorë}, ata nuk i sulmojnë. Te na, neve na sulmojnë se na kemi qenë problem. Ata marrin me dalë, me iu çelë derën, s'kem kurgjo, po dalim po ju çelim derën po ju thojmë "Urrnoni, qe!" Mirëpo n'Gjakovë, (qeshë) osht' diçka shumë karakteristike, dyrtë e Gjakovës kanë qenë shumë t'forta, dyrtë e oborrit, kërkush n'Kosovë s'ka pasë asi dyrë, nuk di pse. Me drujë t'trashë, me... noshta do t'keni rast t'keni pa noj derë, se ekzistojnë hala noshta dikush-dikush i ka. Ka thonë na s'kemi bo kurgjo, po dailm, p'i iu çelim derën, po iu themi "Urrnoni." Dalin deri n'mes t'oborrit, e n'mes t'oborrit kanë dalë me gaz n'dorë. Thotë nona jeme, babës i thotë, "Qityne nuk iu dilet, kokan shumë t'tërbumë. Nuk iu dilet përpara." E lonë gazin midis oborrit dhe dalin te kojshitë qaty ku kemi qenë na. Te kojshitë hini flaka e kemi pasë motrën e madhe asi, kta ma t'médhej se mu fort s'më ka ra hise. T'u ia hekë teshat kojshive, mos me iu djegë teshat. Ata i hini flaka, mandej baba del aty, por edhe babën s'e lejojnë tash kojshitë. I thotë baba, "Qysh more? S'po kom ku me shku, m'hinën n'oborr ushtria". Thotë, "Unë po dal, po dal jashtë n'rrugë". Mirëpo ai ka qenë një plak ashtu, prej frikës sigurisht, del baba

te si me thanë te një kojshi tjetër, e kalon murin, e i zoti i shpisë e shtynë babën, baba e then komën, (qeshë) e then komën.

Kjo motra e madhe ka qenë e fuqishme, e re, vajzë e re kështu e plotë, detyrohet tash me marrë babën n'krah edhe me dalë n'sokak. Dalim n'rrugë, tash n'rrugë edhe na mas tyne, kemi pasë dajën afër, dajën vllaun e nonës teme, ai na ka kqyrë gjatë luftës shumë. Jemi shku n'shpi t'atijna kemi nejtë. Kështu qi, edhe ajo ka qenë një peripeti e madhe. Po fatkeqësia e madhe ka qenë atëhere n'Gjakovë, kur lypshin na shpi me qira masi na djegën, lypshim me qira me gjetë me pagu me pare me shku me banu. U çojke mahalla thojke, "Jo s'muni me ardhë ju ktu", "Pse?" "Se vijnë te ju, e hamë edhe neve, kallet mahalla".

Kështu qi u çu mahalla, s'kanë leju me na pranu, një pjesë. Mandej na kanë pranu mahallat ma t'mira t'Gjakovës, janë mahalla e Dumit, Çabratit e kto janë... nuk e dini noshta ju Gjakovën, edhe aty kemi banu n'mahallë t'Mullah Jusufit derisa u bo çlirimi definitivisht. Këta dy vëllaznit shkojnë, na varin vllaun e madh me '43-shin, atëhere kur i kanë varë, i kanë marrë n'Tiranë i kanë burgosë. E kanë burgosë n'burgun e Prizrenit, n'burgun e Prizrenit nona jeme, babën e kemi pasë t'internumë n'Austri se ka ardhë policia e ka marrë natën babën, kemi qenë t'u fjetë kur e kanë marrë n'burg, e kanë çu n'Austri n'llogor.

E mandej, e marrin edhe këtë... vllaun jem ky që metet n'Tiranë, hyn në çetat partizane të Shqipnisë, vllaun tem ma varin n'Gjakovë, Fahri Hoxhën. Nuk e lejojnë, kur e kanë lajmru veç nona ka qenë. Ajo del, atëhere gratë e Gjakovës kanë qenë t'veshuna me çarshaf {fshin lotët}, me vllaun e vet shkon te hoxhallarët me lutë, "Barëm m'leojni ta marr me vorrosë". Nuk e kanë leju kështu që edhe vdekja e atij ka shku pa e pa kërkush (qan). Dhetë vetë i kanë vorrosë në ni vend, edhe eshnat edhe ma vonë kur ia kanë nxerrë, jonë n'Çabrat qaty që kurrë s'kemi mujtë me shku me pa. Ajo ka qenë vujtje e përjetshme e jona. Po lufta i kishte t'gjitha këto sakrifica. Me mall kurgjo nuk osht, malli shkon e vjen. Me njerëz... qështu na kemi pasë gjithmonë vujtje t'madhe për vllaun e vdekun.

Babës atje n'Austri nuk i kanë kallxu hiç që osht'... i ka ndodhë ajo, krejt kanë ni shokët aty, po e kanë mbyllë prej tij se ai o' lajm i keq. I ka... jehonë t'keqe edhe mrrinë gjithkund. S'i kanë kallxu, me '45-tit që bohet çlirimi, maron Lufta e Dytë Botnore, i lshojnë prej burgut ata, vijnë edhe i kish pasë thonë baba nonës se ajo mandej na kallxojke, "Hiç nuk m'pëlqej që dulën gjakovarët me na pritë aq shumë, diçka ka". Kur hin n'shpi i kallxojnë që qështu, qështu e kanë vra. Por baba jem i ka përjetu ato edhe me forcë burrnore i ka përballu.

Veç realisht krejt luftën e Gjakovës e ka përjetu nona jeme. Na ishim, jo shkojshim me asi, por e ka pasë vllaun që i ka ndihmu shumë, një vlla e ka pasë mandej ai na ka hapë shpinë, jemi shku n'shpi t'babës [së nanës] kemi nejtë deri sa e kemi ndërto shpinë tonë, qaty ku na u ka djegë shpija, qaty osht' e ndërto me kjo shpija e jonë. Ku ka qenë shpija e vjetër, e n'Çarshi t'Vogël gjithkush e din shpinë tonë.

Të gjitha këto janë trauma, kur t'marrish m'i tregu ose me e okupu veten najhere dobësohesh shumë se i ki të gjalla ato kujtimet e tmerrshme edhe vujtjet i ki t'gjalla pa marrë parasysh që po kalojnë vitet. Na mas vdekjes t'vllaut, mo... se tash me t'kallxu t'drejtën tonë qata kemi qenë {numron në gishta} baba, nona,

katër vllazën, tri motra, prej asaj familje kemi metë une ma e vogla, edhe ni vlla e kom ma t'vogël se unë. Krejt jonë shku kanë vdekë, dikush n'luftë, dikush atje, dikush atje edhe kanë vdekë. Ajo shpija e jona e gëzushme, e madhe, e hareshme, mandej s'kemi mujtë...qështu.

Mandej na kemi kriju gjithkush jetën e vet, familjen e vet, ata që kanë qenë gjallë kanë kriju kanë lonë fmitë e kanë lonë... Ai i madhi që osht' varë, ai s'ka lonë kurgjo. Ai ka qenë i fejum, i ka metë gruja e fejume, e ky vllai i dytë ka lonë fmi, ka lonë çika. Mandej, tonë kanë, tonë kemi familje, qysh kemi mrii familje kemi kriju. Edhe prindët, edhe baba na ka rru mirë edhe nana na ka rru mirë, kështu që kanë qenë t'vjetër.

Po m'duket që edhe une pak iu kom përngja se edhe une jom vjetru me moshë qitash (qeshë). E moshë, e mirë osht' po jo e kandshme. Une edhe e kom pasë edhe një fatkeqësi një rrëzim, ajo pak m'ka damtu, jo pak veç shumë. Edhe tash s'po kom t'drejtë m'u anku që osht' ma e keqja, "Hajt" po thojnë, "se mirë je konë deri tash". Mirë kam qenë, e vërtetë osht' ajo, e vërtetë, veç vështirë me e duru deformimin. Edhe n'dhomë m'ka ndodhë një rrëzim, e ajo ka qenë fatale për mu. Se kërkun' jashtë... nuk e di çka ka qenë, a m'ka ra tensioni... tensioni duhet t'më ketë ra, nuk e di.

Jeta Rexha: Na tregoni diçka, mandej mas shkollës fillore?

Myrvete Limani: Puna mas shkollës fillore, natyrisht ato klasë jonë kry me rregull. Atëhere kemi pasë mësuesë, edhe kanë ardhë prej Shipnisë n'fillim. Mandej kanë fillu edhe me shku edhe n'Shipni m'u shkollu, kështu që kemi pasë edhe mësuesë gjakovarë edhe ka përparu shkolla. Me shkollën fillore kanë ardhë shkollat e mesme edhe një ndër shkollat e para t'mesme t'forta që osht' organizu ka qenë Shkolla Normale. Shkolla Normale e Gjakovës ende edhe sot osht' e vlefshme. Edhe mas krymjes së shkollës fillore, Shkolla Normale ka qenë si shkollë e mesme si me thanë kur shkon tash në ni shkollë të kategorisë profesionale.

Atëhere ka qenë e nevojshme Shkolla Normale për arsye se duhet me kriju kuadra për me msu. Kuadrat kanë qenë shumë të nevojshme, domethanë mësuesët me shku nëpër fshatëra, me mrii gjithkun, me hapë shkolla, mos me metë asnjë vend pa shkolla. Jo me ni shkollë, po me shumë shkolla për arsye se popullata e Kosovës ka qenë e re, fmi ka pasë plot. Edhe një ndër shkollat e para ka qenë Shkolla Normale.

Unë jom nxanëse e Shkollës Normale dhe me ni grup gjakovarë kuptohet sa ka qenë... i kemi fotografitë e ndryshme. Ka qenë shumë e njoftun, si me thonë sot, "E kom kry shkollën e naltë n'Kosovë", qaq ka qenë e afërt. Beqir Kastrati ka qenë drejtor, ai që e ka emrin n'rrugë. Mandej kanë ardhë arsimtarët prej Shipnisë n'fillim se s'ka pasë. Edhe me ata kemi kry shkollën, kanë fillu mandej Shkolla Normale, janë hapë disa paralele. Une i takoj paraleles t'parë t'Shkollës Normale, e kam edhe fotografinë, mund t'ju tregoj, t'klasës. Edhe, jonë hapë edhe shkolla nëpër vende të ndryshme, kështu që arsimiti ka fillu të zhvillohet. Prej shkollave normale kanë fillu t'hapen shkollat e nalta.

Shkolla e Naltë kuptohet e ka pasë msimin ma t'gjatë, programet t'natyrës ma t'ngarkume, se me kalimin e klasave t'nalta, ke pasë edhe programe t'ndryshme që ju kanë përgjegjë moshës dhe shkollës. Edhe prej asaj, mandej kanë dalë shkollat e nalta këtu. Na kemi, për shembull unë kom pasë fatin me kenë n'klasën e parë n'Normale. Prej Shkollës Normale atëherë kanë fillu' me na pranu Beogradi nëpër shkolla. Nji grup i shoqnisë sonë i Shkollës Normale për shembull, kemi shku n'Shkollat e Nalta Pedagogjike n'Beograd, edhe une jom nji ndër ato që kom qenë e me disa shoqe e shokë të mi atje në Shkollën Pedagogjike t'Beogradit. Na kemi pasë probleme se, veçanërisht gjakovarët nuk e kemi ditë gjuhën serbishte, edhe unë kom ditë shumë pak. Me marrë vesh po, po me komuniku për shembull kur ka ardhë koha me dhonë praktikën ose ato, osht' dashtë me msu përmensh fjalitë e ndryshme, e pytjet.

M'kujtohet kur kom dhonë orën e parë n'Shkollën Normale, praktikë jepen, sikur tash që organizohen. Ma s'pari kom kërku falje prej atyne nxanësave, ato kanë qenë beogragjane do vajza t'rrituna, do vajza t'veshuna edhe kisha ni dozë t'frikës se mos nuk t'nderojnë sa t'japish msim (qeshë). E m'kujtohet fort mirë kom kërku falje, ju thashë, "A dini çka? Unë gaboje se nuk e njof gjuhën serbishte me ju asishne".

E kom pasë suksese të ndryshme, por natyrisht me mundime ma t'mëdhaja, e kom kry Shkollën e Naltë Pedagogjike n'Beograd, Historia dhe Gjeografi. Kom pasë suksese, mirëpo atëhere edhe Kosova ka pasë nevojë për ne. Nuk t'lishin me vazhdu, disa nuk lishin se dojshin me u shpërnda nëpër Kosovë tash, se po hapen shkollat si kpurdhat. Po hapen shkollat, u deshke edhe profesorat arsimtarë me pasë t'përgatitun, prandaj nji pjesë e madhe jemi kthy me kohë. E kom edhe nji fotografi kur jom kthy n'Gjakovë menihere n'gjimnaz n'detyrë, jo me pritë a m'marrin, po me urdhnesë, "Lajmrohu nesër, ose, "Lajmrohu sot". Qashtu ka qenë atëhere, s'kemi pasë me pritë hiç asnji sekond. Kështu që asi...

Mandej une jom regjistru për ma naltë, po gradualisht nji pjesë e kom kry, nji pjesë kom metë pa kry për arsye se kom kriju familjen teme. I kom kujtu... kujdes, kom dashtë familjen me respektu, se pa hekë keq familja edhe shkolla nuk kryhet. Kështu që, mirë, tonë jetën kom qenë e angazhume, kom qenë e lavdume. Si t'ju thom kom punu në organizatat politiko-shoqënore. Kom qenë anëtare e Komitetit edhe n'Gjakovë edhe këtu n'Prishtinë n'kohën e Mahmut Bakallit. Kom qenë në t'gjitha delegacionet e Kongresit t'Partisë, Lidhjes t'Luftarëve, sindikatave t'Kongresit t'Jugosllavisë. Kom qenë shumë aktiviste edhe kom mrrri me mrrri në t'gjitha vendet. Atëhere e kom pasë t'libër. Po, apat shpinë, fmitë, tre djem i kom lindë (qeshë) babën e Lurës, që e kanë nji babë t'përsosun. Pse osht' djali jem kuptohet, po edhe pse osht' vërtetë. A s'e lavdon ti babën hiç a? (Qeshë).

Lura Limani: Po!

Myrvete Limani: Une tre djem i kom bo. Kom pasë nji fatkeqësi, djali e ka kry shkollën, ma i vogli, qe fotografinë ku e ka {dëfton kah fotografia mrapa vetes}. Arqitekt i shkëlqyshëm, tonë t'shkëlqyshëm me msime, m'ka dekë. Mas dekjes t'djalit unë s'kom dalë mo n'qytet, jom mbyllë. Ajo ish e pamundun! Sa isha ma e re shkojsha nëpër këto mledhje, nëpër... veç masnej s'kom mujtë me ju përgjegjë. Kom vujtje t'madhe shumë për to. I zgjutë shumë, jo pse osht fmija jem po erdh ajo... Nuk dihet.

Mandej mas dekës t’ djalit, mas pesë vjete m’ka dekë edhe Xhahiti baba, gjyshi i ktyne. Edhe babën e tyne ka qenë njeri i shkëlqyshëm. Prizrenas, shok i shkollës në t’gjitha kohnat, e kështu që gati që jemi rritë edhe bashkë. Ky prej Prizrenit, unë prej Gjakovës. Ka qenë njeri i përsosun, kështu që këto vujtje i kom jo t’zbehta veç secilën herë ma e madhe, e ma e madhe. Mirëpo, ish një kohë që s’po mujshe mo me qëndru. Falë Zotit familjen këtu tash e kom plot, edhe dy djem i kom me thmi me krejt me tona t’mirat. E kom jetën e lumtur kështu, por me dhimbje, me dhimbje.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë ndjenje ka qenë me shku prej Gjakovës n’Beograd?

Myrvete Limani: Ajo ka qenë një ndjenjë e shkëlqyshme. Si me shku në një vend t’Evropës, një sukses i madh jetësor. Fluturojshim, fluturojshim n’Beograd kur kemi shku me shkollë. Na kanë pritë mirë, ma vonë fillunë se marrëdhëniet dhamin, natyrisht, veç edhe na kanë çmu. Tash mos me folë, edhe këtu nëpër shkolla thojmë kanihere kjo shkollë ma e fortë ose ma e dobët, ma asi, ata shumë edhe na kanë ndihmu.

Ju thash pak që unë... na gjakovarët serbishten edhe sot nuk e dijmë, hiç n’Gjakovë, hiç nuk... I kom nipat p’i ju thomë, “Qysh more, marre mos me ditë?” Tha, “Me bo me folë serbisht na thojnë, ‘Koke tradhëtar!’” Edhe me t’vërtetë qëtash u dëshmunë serbët, bonë kërdrinë n’Gjakovë. Na e kemi pasë një rrugë n’Gjakovë e thirrshin “Ruga e shkijeve”, tonë kanë ditë shqip, tonë kanë qenë t’organizumë në organizatat e rinisë mas çlirimit, ata dulën katila edhe vranë mjaft gjakovarë gjatë kësaj luftës t’fundit. Familje të tana i kanë shu qëta shkijet e Gjakovës. Mos me ta marr mendja, a na gjithmonë kemi qenë shumë t’hapun n’shoqni me ta. Por edhe ata kanë ditë shqip, mirëpo ka qenë një rrugë e veçantë thojshin “Ruga e shkijeve”, pak lokalizëm kuptohet, veç ato e kishin pas rujtë ata për m’u hakmarrë. A na gjithmonë, na shqiptarët shumë t’hapun shumë t’sinqertë, shumë... nuk po di si t’ju them. Me sy t’urrejtjes kurrë s’i kemi shiqu ata, a osht’ njeri i mirë, osht’ i përshatshëm pa marrë parasysh që osht’ shka a çka osht’s, na kemi qenë t’mirësjellshëm. Veç qitash jonë dëshmu’, n’fund t’kësaj lufte jonë dëshmu’ shumë keq.

Pjesa e Tretë

Lura Limani: A keni pasë ballista n’Gjakovë gjatë luftës?

Myrvete Limani: Po ka pasë.

Lura Limani: A jeni njoftë n’familje, a jeni njoftë n’mes veti?

Myrvete Limani: Eh çfarë pyetje bane (qeshë). Ballistat kanë qenë kundër partizanëve. Ballistat kanë qenë me Ballin Kombëtar. Balli Kombëtar nuk ka qenë me Luftën Nacional Çlirimtare, Nacional Çlirimtare, çlirimi i lirisë t’kombit ka qenë. Ballistat kanë qenë në shërbim t’okupatorit. Dhe me ju thonë të drejtën, n’këtë pikëpamje interesant une si e vogël diçka jom marrë edhe me politikë. S’di a jom marrë, a çka kom bo, as vet s’di kur e boj analizën. Deshta me ju kallxu’ diçka, veç s’po ju kallxoj se tutna që e shënoni {

drejtohet intervistueseve}. Ata ballistat majshin kapuçat e bardhë si shqiptarët. Në t'vërtetë ata ishin, kjo, ishin ma nacionalista se sot që jonë shqiptarët dhe qëllimi i shqiptarëve gjithmonë ka qenë bashkimi me krejt popullin shqiptar, po ai fat si duket kurrë s'ka me u realizu megjithë që po asishne... E Balli Kombëtar ka qenë n'shërbim t'gjermanëve edhe italianëve. Qysh thojnë rryma, këto kanë qenë rryma.

M'kujtohet një here ishim n'rresht që dalin fmitë me i marrë n'oborr t'shkollës, bien zilja dhe u rreshtojshim aty edhe secili mësus dilke e merrke klasën e vet. Edhe tash duhet t'ketë ka' n'shkolla fillore, presim, bjen zilja, rreshtohen, secili hin n'klasën e vet me msusin e vet. Nuk du me ju kallxu, po kom pasë bo ni gabim me ni mësus temin. Me atë gabim, ai m'shtini n'burg po unë hiç e vetëdijshme. Fmi bre, fmi, s'po di sa vjet i kom pasë. Edhe e shoh me plis, edhe na tash partizanë, komunistat, këta ishin njerëz ma t'drejtë se këta krejt ishin ma t'drejtë se këta po lypin çlirimin edhe prej italianit, edhe prej gjermanit, edhe krejt, partizanët kanë qenë ata. Ballistat kanë qenë n'shërbim... n'shërbim t'okupimit apet, me italianë me asi. Këto janë politikat të cilat kërkush s'munet me iu vnu kufi.

Lura Limani: E çka ndodhi me mësuesin?

Myrvete Limani: E mandej, e bona ni gabim, po m'vjen keq me thonë e shënoni ju aty (buzëqeshë)... kurgjo m'shtinën n'burg. E ku m'shtinën n'burg, m'shtinën nër shkallë t'shkollës, a din që i kanë për dru që i lonë. Une asi... edhe haptaz e thashë një fjalë e m'shtinën n'burg. "Hajde", m'qitën prej rreshtit e m'shtinën, duhet t'i kom pasë noshta dhetë vjet. Noshta ma tepër, nuk e di. Hina n'burg. E na kemi qenë n'shkollë, kishim shoqinë tonë, ka qenë Cen Zherka, kanë qenë këta, jemi konë t'moshës, shokë e njëni tjetrin e rujshim e mbrojshim. E m'shtinë n'burg, qaj msusi kur e fola unë qat fjalën, (qeshë) e m'shtinë n'burg. U tutsha tash, thojsha po m'dalin mijtë nër shkallë, se aty drutë i lijshin, secila shkollë e ka përfuni shkallëve me dërrasa t'rrethume për m'i lonë drutë e dimnit. E nuk m'lanë shumë mandej, veç hala m'vjen marre çka kom folë. E nuk mund t'them. Mos m'i pasë aparatit ju kisha thonë se s'kish besu kërkush.

Lura Limani: Ani, a ta ndalim?

Myrvete Limani: Ai dul me plis, mu m'boni përshtypje, dul si përfaqësus i Ballit Kombëtar e une si tjetër, tjetër rrymë ma përparimtare, po fmi edhe une isha. Nejsë... le t'maron qështu. Veç une e maj n'mend se e di që e kom bo gabim. E thanja jeme ka qenë e gabushme. Ai njeri, edhe vet njeriu e sheh edhe isha n'rresht qaty, e lshoi një za, nuk m'pëlqei. Me një fjalë tjetër i lashë me kuptu që ti je n'shërbim t'okupatorit, shumë gabim, une nxanëse, fmi. Veç apet u bo i mëshirshëm mësusi se ka mujtë naj shuplakë me ma futë (qeshë), me ma kallë ftyrën. E qështu e ka rinia, e ka shkolla, ka kujtime t'mira... megjithëqë unë mirë gjithmonë se na vet, vajzat jemi ma t'urta, gjithmonë kemi qenë, në shkollë e...

Mandej unë kom dhonë mësim, unë shumë e kom dashtë arsimin. Kom pasë suksese n'shkolla anej knej, besoj që në t'gjitha lamitë ku kom punu kom pasë.

Kaltrina Krasniqi: Çka keni punu gjatë jetës?

Myrvete Limani: A?

Kaltrina Krasniqi: Çka keni punu gjatë jetës?

Myrvete Limani: Gjatë jetës, unë ma s'pari kom qenë n'gjimnaz n'Gjakovë. Prej atyhit kom qenë n'gjimnazin e Prizrenit, kom punu n'Prizren. Prej Prizrenit jemi ardhë n'Prishtinë kom punu n'arsim, prej ktuhit kom punu' në t'gjitha organizatat politiko-shoqërore me arsimin e naltë, me asishne me krejt kom qenë në t'gjitha forumet. Kah fundi kom qenë drejtoreshë e t'gjitha çerdheve t'Prishtinës, e m'kanë lutë edhe përpara me marrë naj post, s'kom dashtë për arsye se tre djem i kisha, thosha ta kenë shpinë e ngrohtë se mandej ata t'rijtë dalin për rrugë, jo bukën, jo drekën jo... hazër. Kështu që, gjithkun suksese. Mandej në t'gjitha forumet partiake sindikale t'Lidhjes luftare nëpër kongrese kom qenë: {numron në gishta} Kongresin e Partisë t'Jugosllavisë, Lidhjes Luftare t'Jugosllavisë, të gjitha forumet. Delegationet kudo që ka qenë dikush i pari, kom qenë unë. Kom pasë suksese.

Mandej, kur shkova me punu me këta fëmijë, me fëmitë unë s'punojsha, po kisha pesë-gjashtë objekte, mandej edhe ndërtumë objekte t'reja, shpija t'reja për asishne. Ato i ka Prishtina, sukses. Mandej punojsha me krejt çerdhet e Kosovës. E hapshim kte, në '70-shin kemi shku n'Shipni.

Shipnia ka qenë shumë e egër n'vitin '70. Nji delegacion i joni i Kosovës, i Prishtinës, merre me mend kur shkojshim atje, çerdhet vorfni, mjerim, mos vet. E ktu te na kanë qenë shumë t'përparumë, shumë. Mandej n'krejt Kosovën bashkëpunojshim, ndihmojshim, thirrshim kolektive e me krejt, ka qenë nji harmoni e hatashme. M'kanë lutë në disa vende, po unë fort nuk dojsha kështu me pasë angazhim t'përhershëm për shkak t'familjes, ta ruj familjen, t'i ruj njerëzit.

Mandej baba i fëmive t'mi, qe ku e keni fotografinë {dëfton kah fotografia mrapa saj}, ka qenë një njeri i përsosun. Nji familje e shnohtë që rrallë mund t'jetë dikun n'Kosovë. Edhe ky shkoi mas Shpendit, ky djali e ka pasë emrin Shpend ma i vogli. E kreu arqitekturën, krejt i shkëlqyshëm. E te tretë fmitë që i kom, tonë jonë me fakultete t'nalta. Por nuk e di ktij iu shfaqë nji smundje, une mas ktij edhe une jom mbyllë. Une shumë e kom përjetu rondë. Atëhere u izolova me ka krejt. Veç edhe ajo nuk ish mirë, nuk ish mirë se tash e ndij nji vujtje shumë ma tepër. Çda gja po u duhke me masë, kurgjo kërkuj s'po mujshe me i bo, asgjo nuk kthehet, nuk po kthehet. Unë çdo konin e kisha këshillu që duhet dhe proceset natyrore me i marrë normal. Normal sa mundesh, sa s'mundesh, kurgjo hiç. Qështu... unë mandej jom izolu prej nji aktiviteti t'jashtëzakonshëm. Jom shtim.....[e pakuptim.]. S'e di...

Lura Limani: A po na tregon ndonji ngjarje, kur keni shku n'gjimnaz n'Gjakovë?

Myrvete Limani: Po qe fotografinë ku e ke.

Lura Limani: Po kur? A po na tregoni ndonji epizod?

Myrvete Limani: '51-shin.

Lura Limani: A po na tregon për qat kohë t'viteve '50-ta?

Myrvete Limani: Ah?

Lura Limani: A po na tregon për qat kohë t'viteve '50-ta?

Myrvete Limani: Unë qat vend e du shumë se osht' vendi jem, edhe tonë gjakovarët i du shumë. Mirë kemi pasë kolektivin e mirë. Ashtu, edhe për herë t'parë kemi qenë n'gjimnaz, ajo domethanë shumë, ka qenë një sukses i madh shumë. Kështu që, kujtime shumë t'mira kom për Gjakovën. Mandej, aktivitetet politiko-shoqërore gjithkunj kom qenë, edhe n'Gjakovë.

Edhe diçka du me ju kallxu se tash ma kujtoi.

Atëhere krejt gratë e Gjakovës kanë qenë t'mbylluna me çarshaf, jo vetëm t'Gjakovës, po krejt Kosovës. T'reja, t'vjetra, tona t'mbylluna me çarshafa, e keni pa me çarshafa qysh duken. Edhe tash ishte aksioni n'Gjakovë me e hekë çarshafin. Une sa kom qenë, kom qenë e re more s'e di a i kom pasë dhetë vjet, 12 vjet, po mendoj për çarshaf. Punojsha me gratë, se kanë qenë shoqatat e grave ato gratë ma t'vjetra ma asi...Edhe unë punojsha me ta. Kishim aksion me shku n'çdo familje me e bindë që 'nona jote, motra jote që jonë t'mbylluna duhet me hekë çarshafin'. Edhe ky ka qenë një aksion i përgjithshëm m'u shplu gratë, ajo ka qenë shumë e vështirë. Tona n'Gjakovë kërkon s'e ki pasë kështu serbez si na që ecim, me çarshaf, e dini, keni pa çka osht' çarshafi. Ajo ka qenë detyra primare, me hekë.

Edhe unë si ma e re me gra shkojsha, punojsha qaty, rrijsa, bojshim asishne. E kemi pasë sukses, u hekë çarshafi n'Gjakovë. Mandej u hekë n'krejt Kosovën gradualisht, u hekën n'tonë Kosovën. Kishim kurse të ndryshme partiake. Na mësojshim, a din kur shkojshim me kry një detyrë, na jepshin këshilla, ani që isha e re, na jepshin këshilla, ishte Komiteti, ishte ajo... Kanë qenë t'organizumë atëhere, edhe atëhere nuk ka qenë jo unë po punoj ma shumë, ti ma pak, ose ajo shoqnisht krejt këto shkojshin marë e mirë, edhe kishin sukses. Mandej kur erdhëm prej Beogradit menihere punën, menihere vendimin, menihere as mos me pritë, as me shku me folë me najkonin m'i thonë... Kemi pasë edhe privilegje, por edhe kemi punu shumë. Generacioni i asaj kohe, mandej natyrisht u shpërndamë. E n'Prizren mandej, edhe Prizreni ka qenë qashtu, mirë ka qenë edhe n'Prizren.

Kaltrina Krasniqi: Në çfarë mënyre i stimulojshit gratë për me hekë çarshafin? Si stimuloheshin ato?

Myrvete Limani: Hiç, i stimulojshim haptaz, "Ka ardhë koha me hekë çarshafin!" Besim. Krejt organizatat politiko-shoqërore, secili e ka pasë për detyrë familjen e vet. Edhe nona jeme ka qenë me çarshaf, e që osht', barëm ato e maj n'mend mirë. Kur erdh koha me hekë çarshafin se u organizojshin tubime sikur tash që dalin qitu te... n'shesh. Tona gratë, ekzistojnë fotografitë e sene, me e hekë çarshafin, dikush e hekë me nervozitet, dikush e hekë kadale. Nonës teme i vijke marre, thojke, "Qysh une jom plakë, me hekë çarshafin?", kanë pasë për detyrë me dalë n'shesh, po ekzistojnë fotografitë. Fotografi t'gjalla, e hekshin ato, e u shpjojshin. Ato që ishin t'reja u vesh'shin me kostime t'reja, me pallta, me mantilla, i rregullojshin

flokët te berberët, te frizerët dhe dilke. Na mas tyne shkojshim, iu bojshim shoqni, që ishim na t'rijë. Vajzat e reja jonë mbyllë, vajzat e reja, si u bojke pak vajzë e zhvillume, ato u duhke me izolu. Jo sikur tashti, gjithçka sllobodë² [shlirshëm].

Tash s'ka mo, atëhere s'ka pasë. Atëhere edhe n'qoftë se ki bo, e ki bo shumë msheftas, ose prej ndryshe ke qenë jashtë tefterit njerëzor. Veç ajo kohë ka qenë e tmerrshme, gjynah. Po edhe për kohën e sodit, edhe kjo osht' e tepërt. Por mesatarja osht' gjithmonë shumë stabile dhe shumë e mirë, shumë e nevojshme. Gjithçka ka kohën e vet, gjithçka me kohën e vet, me sjelljen e vet me... Une hala nuk e kuptoj edhe m'vjen shumë keq kur i shoh disa që jonë aq t'shlira n'vendet e punës me kry edhe procese tjera, ato jonë t'palejshme edhe jonë të damshme për njeriun. S'ka gjo ma t'bukur se nderi edhe morali. Atëhere je serbez³ kudo, në një qind vjet, në 201, në një shtet, në një qytet me hi n'serbez, ajo osht' shumë me randësi njerëzore. Ka sene që tash nuk m'pëlqejnë, natyrisht nuk kom me folë, as s'flas për kërkon, gjithkush le ta run vetveten. Veç që jonë t'damshme... p'e marr tash ju jeni t'reja veç t'damshme janë, nuk i takojnë brezit n'atë formë qaty, vetëm qaq, vetëm qaq. Nashta osht' kjo konservatizëm, noshta s'ka kuptim që po them, po natyrisht unë jom me moshë e vjetër, kom kalu nëpër kohnat e ndryshme, edhe me gabu mu m'pëlqen respekti i posaçshëm. Edhe une i respektoj njerëzt e kom qef me m'respektu.

Lura Limani: Ku jeni njoftu me Xhahidin edhe qysh jeni njoftu?

Myrvete Limani: Xhahidin unë shok klase e kom pasë në Shkollën Normale. Kemi qenë shumë shokë t'mirë, shumë shokë t'mirë, secili n'punën e vet, po jonë momente që shfaqen mandej. Jonë momente, kështu që pa moment s'munesh me kërkonin me u bashku. Veç që edhe n'shkollë n'Beograd kemi qenë bashkë. Një shok shumë i përshtatshëm, jo tash du me thonë ashtu, po qashtu ka qenë, qashtu ka qenë. Ajo ka qenë tjetër kohë kuptohet, nuk ke mujtë me u çu përndryshe s'kishe mujtë me shku n'shkollë. E tash, tash o' tjetër kohë, une s'mund t'i caktoj, s'jom njeri që mund t'i kufizoj kohnat. Vet zhvillimi i kohës i bjen gjanat në veti edhe t'dobishme, aty une... Veç jo, s'kemi pasë gjo. A din që shokë t'mirë kemi qenë. N'kuptimin e asaj – shokë t'mirë.

Lura Limani: Okej, nuk e mendova. Dashta me t'vetë...

Myrvete Limani: Po, po qashtu. Qashtu po du me thonë, qashtu si me çdo shok tjetër. Vjen momenti, as vet s'e din, vjen momenti që vendos.

Lura Limani: Masnej jeni martu edhe çka...

Myrvete Limani: Po, krejt normal kemi shku me t'gjitha parimet normale.

Lura Limani: A po na tregon qysh je martu, e ke shku' masnej n'Prizren?

² *Sloboda*, në serbisht, liri.

³ Turq.: I lire.

Myrvete Limani: Kqyre more e kom fotografinë, nuse jom shku, kom fotografinë. Kanë ardhë m'kanë lypë te baba jem.

Lura Limani: Po?

Myrvete Limani: Kryesore, me ditë qysh osht' familja. Na Prizrenin nuk e kemi njoftë, se une gjakovare, ai prizrenas. Por djali i mirë, shok i mirë si me çdo shok tjetër. Kështu që osht' dashtë me ditë se zakonisht edhe çdo familje kur don me feju çikën e vet, e kqyrë familjen. Familjet kqyren a jonë familje zotnish që s'kanë gjatë jetës probleme. Po mendoj, t'natyrës t'rondë se familja ekziston ka t'mirat edhe asi. Mandej familje me tradita, a jonë t'respektumë t'qytetit. Edhe na familjen e Xhahitit nuk e kemi njoftë, baba jem s'e ka njoftë. Jonë persona që n'atë rast merren me atë asishne, kështu që mandej del familja e Xhahitit, familje shumë e mirë e Prizrenit me tradita me asi, edhe qashtu ka dalë.

Zakonisht përpara kur jonë bo familjet edhe n'Gjakovë edhe kudo n'Kosovë, si t'don çika m'u feju', e kqyrë edhe familjen. Ka familje që jonë problematike, ka familje që jonë t'egër, ka familje që jonë vrasës, ka familje që ekonominë e kanë t'dobët, ka familje që qyteti nuk i respekton, po du me thonë qato gjana. Nji familje që osht' e respektume prej qytetit edhe që nuk ka pasë probleme jetësore, po mendoj, barëm në dy generacione ose tri, ajo osht' familje e mirë. Familje e mirë osht' çështje me i rujtë marrëdhانيت mandej m'i pasë t'mira se marrëdhانيت mund t'sakatohen me njerëz që jonë ma t'ligë, e me njerëz që jonë asi... Për shembull në nji familje t'mirë edhe mos me pasë pare, edhe mos me pasë bukë me hongër, ti je sabërli e duron atë familje. Ke hi në nji familje t'vorfun që nashta s'un po ti siguron kushtet jetësore, e jo me thonë jo mu s'po asi, e me dalë.

Martesa duhet me kenë gjaja ma stabile jetësore. Se vijnë edhe fmija, mandej edhe për edukatën e fmisë duhet m'u kujdesë që edhe ata t'rriren mas veti t'lonë gjana t'mira. Qatyne ju thomë familje t'mira, që barëm dy-tri generacione s'kanë bo probleme. Ekonomia kajhere o' ma dobët, kajhere... mundesh me kenë edhe i vorfun, por ku je familje e mirë, e duron ato, e duron. A kur je familje e ligë, "A te ti s'pasna me hongër, te ti asishne..." e me thonë, "Jo, s'jetoj". Duhesh me t'mira e me t'kqija atë familje me pranu. Me t'kqija po mendoj kushtet ekonomike se jo, s'po hijmë n'detale tjera, nuk osht' ajo e drejtë njerëzore. Se aty kur nuk ke edukatë, qato mungojnë, ato njerëzore mungojnë. Mandej, kur je i ri njeriu bon gabime kajherë. Kur gufojnë njerëzit për shkak t'atyne gabimeve, ajo osht' gabim shumë... njerëz jemi.

Pjesa e Katërt

Jeta Rexha: Ndoshta tash kishit nisë me na folë për vitet e '90-ta?

Myrvete Limani: Ashtu ju kisha lutë pak ma me za për shkak...

Jeta Rexha: A po nini?

Myrvete Limani: Po, po ju nij, veç kanihere po ju boj pyetje.

Jeta Rexha: Jo, hiç s'ka lidhje. Për vitet e '90-ta edhe prej atyhit kalon te lufta.

Kaltrina Krasniqi: Ndoshta mundeni me fillu prej vitit 1989 kur osht' marrë autonomia e Kosovës.

Myrvete Limani: Une po flas pak për qato demonstratat e '80-shit. Kurrë s'i harroj, ato kanë demonstrata shumë të mdhaja, edhe shumë armiqësore që kanë... mo shkijet kanë qenë t'tërbumë tepër. Ka dalë Fadili, s'ka pasë se Fadili ka qenë atje e ka kuptu se ai ka qenë n'forumet e nalta n'Beograd. Qysh e kanë, shkijet e kanë përgatitë planin me ardhë n'Kosovë edhe me likvidu rininë shqiptare, me likvidu. As s'ka pasë qare, a di çka domethonë qare pa dalë me i kallxu këtij popullit, rinisë, "Ruhi se," e ka përdorë një shprehje hiç t'kandshme. Veç nuk ka pasë t'drejtë... ka pasë t'drejtë. Qysh me i kallxu' se shkijet jonë bo gati me likvidu, ai ka qenë qaty e ka ni, se edhe ato kanë dashtë m'i përjashtu', edhe krejt shqiptarët çka kanë qenë aty. Edhe kanë bo nijet me vra rininë e Kosovës, shqiptarët m'i vra. "Ju," asi "largohuni, mos rrini nëpër rrugë se..." asi. Dikush i ka marrë ato t'tmerrshme. Une për me t'kallxu' sa t'urrej ty, ai tjetri t'kallxon se une jom bo gati me ta marrë jetën. Po qysh me t'kallxu' me t'thonë ruju se je e shënume me vdekë, edhe Fadili s'ka pasë faj.

Ai Fadili mandej e patën përjashtu mandej pa asishne. Fadili une s'di qysh ka shpëtu, kish pasë jetë. Sa herë shkijet kanë bo nijet me likvidu. As s'ka luftu me shkije, ka luftu vllaznisht t'u kujtu që Kosova e fiton pavarësinë, bohet Kosova e veçantë e asishne. Por lufta o' luftë e poshtë. Mandej vijnë tjerët edhe ta marrin t'drejtën. Kqyre ti je e pavarun, demokraci, ta kanë marrë Mitrovicën veriore. Çka po munesh me bo? S'pi lonë shpija me ndërto, shkijet jonë qashtu. Edhe s'ki t'drejtë me folë mirë për ta. Megjithëqë na jemi mllef, une që po flas, sot po flas vetëm me ju lirisht se turp. Qe tash po duhet me lshu, hajde Gjyqin e posaçëm, denimi i shqiptarëve, e kto asi.

Lufta e '90-tës ke ni luftë me shpresë, me shpresë. Filloi lufta, tani lirim. Fadili thojke veç që jom plakë se edhe nihere i kisha veshë opangat, kisha dalë n'mal, nuk arritën me fitu pavarësinë se bota s'ta jep. Shkijet s'po ta japin, bota s'po ta japin. U deshtë mandej me politikë me Titon anej knej se une me Titon disa here jom taku. M'bijke si delegacion si asishne. S'ka pasë qare, a mundesh ni grup shqiptarësh, kosovarë me i asi... po fati i madh që kanë qenë shumë republika, se t'ishim konë vetëm me serbë {fërkon duart}, ishim shafitë përtoke. E kemi pasë Kroacinë, Slloveninë sado kudo ata na kanë majtë krahun. Kjo politika osht' shumë gja e poshtë.

Kaltrina Krasniqi: Ku keni qenë ju kur kanë ndodhë demonstratat e vitit 1981?

Myrvete Limani: Në vitin '81, kom qenë në objektin Ulpiana, kom pasë plot objekte me fmi t'vogjël. Kom nejtë n'oborr tu rujtë mos me ardhë dikush fmi, se as prindët nuk mujshin me ardhë m'i marr fmitë. Qështu ka qenë {afion duart}. E këtu kanë qenë këta t'shpisë Xhahiti, n'shpi këtu, unë kom nejtë atje. Thojsha po hijnë po ma marrin naj fmi, isha deri n'momentin e fundit i kom rujtë fmitë. Kanë fillu se s'mujshin me dalë se atje ka qenë tollovia ma e madhe n'breg te studentat e te, ajo Ulpiana a e dini ku

osht. Aty kom nejtë, edhe n'oborr kom nejtë, thojsha po m'afrohet dikush jo aty s'guxon kush me m'i prekë fmitë pa shku vet. Edhe asi kom nejtë, deri sa fillunë ata me u tërhekë me u tërhekë. Erdhën prindët njo kah njo me i marrë fminë, erdhën prindët me i marrë fmitë, deri sa m'ka shku fmija i fundit, tek atëhere jom largu me ardhë n'shpi.

Kur jom ardhë, jom nisë me ardhë n'shpi, qështu kanë qenë {tregon me dorë turmën}, thojsha qetash kur m'gjunë dikush. Se, edhe unë kom pas hasëm shkina, krejt kolektivin një pjesë t'madhe e kom pasë edhe n'shkollën "Aco Maroviç" edhe n'çerdhe kom pasë shkina. Edhe ato kanë qenë haptaz kundër meje, haptaz kanë qenë. Une me politikë, me asishne, s'kishe qare, s'kishe qare. Ose me politikë ose hiq shko mbyllu, s'munesh as me punu. U deshke m'i rujtë ata fmi, kush e çon fminë e vet n'dorë t'shkijeve pa kenë une ose... edhe një edukatore tjetër ose tjetër ose... shqiptare. Shumë e kom pasë punën e rondë. Kemi pasë shtatë-tetë objekte, ti n'shpi e ki edhe tutesh çka po ta gjonë, n'shpi qe qitu fminë tond. Jo se fmi t'vogjlit t'njerëzve t'hujë, t'ndryshëm që ata deri sa u ktheshin prej punës, unë e kom pasë punën shumë t'rondë. Veç kom pasë sukses, oh Zot. Falë Zotit një kiks qikaq s'em ka ndodhë.

Edhe mandej tashti fillunë me shkru gazetata. Për mu a din sa kanë shkru yhy, armike përtej armikes unë. "S'i ka marrë fmitë shqiptarë, nuk po i kqyrë fmitë serbë... fmitë serbë nuk i ka marrë, shqiptarë krejt." Shtatë-tetë objekte kanë qenë të mdhaja. N'Ulpianë tri, mandej n'Kodrën e Diellit, mandej n'Obiliq, mandej kemi pasë...

Ashtu ju thashë sa objekte, tri i kemi pasë n'Ulpianë, në Obiliq njo, n'Kodër t'Diellit dy n'Kodër t'Diellit, pesë-gjashtë objekte edhe u marunë katër objekte t'reja të mdhaja. Secili objekt natyrisht me numrin e fmive kishte fmi, edhe fmitë i pranojshim me lutje. Qëkaq fmi shqiptarë, qëkaq serbë, simbas asishne. Edhe dikujt iu realizojke, ka pasë edhe shqiptarë që u nervozojshin se s'mujshin me ia pranu [fëminë]. Mandej financimin e kemi pasë prej BVI-së [Bashkësia Vetëqeverise e Interesit] Sociale t'Prishtinës. BVI-ja Sociale e Prishtinës ka qenë e udhëhequn prej serbëve, një malazet një serb ka qenë. Edhe kur shkojshim n'mledhje tashti, ishim n'atë mledhje që osht' për me nda pare, për me nda rroga, për gjendjen ekonomike të objektit se kemi pasë edhe kuzhinën qendrore, kanë hongër edhe kanë pi aty.

U deshke me lypë pare, ata tashti bojshin problem. Për shembull qikaq pare m'duhen, qikaq pare m'duhen, financimi. Ishte një serbe aty, ose dy serbe ato krejt kundër meje. Edhe tash ata iu pëlqejke, e mendojshin tepër sa që ju thojsha, "Pse," thojsha, "Zašto ti vi [e pakuptim.]. Nejse, po ka qenë një prej tyne Jovica Ivančević. Ai ka qenë i mirë, e mendojke, e mendojke tepër kur merrsha m'u çu, "Myrveta dobit češ sve!" ma bojke, "dobit češ sve". Po ka qenë një shqiptar shumë njeri i mangët. Edhe shqiptari ta bon t'keqen ma t'madhe. Mos me thonë mbiemnin se duhet ta njifni, m'vjen keq me ni. E po du me thonë kom hekë shumë, shumë detyrën e ronë e kom pasë. Mandej, u duhke fmija me dalë i sigurtë. Merre me u vra ose asishne yh. Mandej vijshin nanat, thojshin, "Ti p'i merr me hatër, këto me hatër, ato pa hatër".

Erdh njona po kritikon mos po i merr fmitë me pare, kur m'ka thonë qashtu e kom kapë për krahu thashë, e shkeva grunë. Po shkoj te... kom qenë edhe ashpër, po shkoj te sekretari, ai po ma bon, "Drejtoreshë

t'lutem kadale”, tha, “Jo, jo une kështu”, “Jo” thashë, “ki me kallxu kush ka marrë pare. Ose ki me kallxu ose tash ta vnojnë etiketën palidhje”. E kapa, e pata shky grunë, qaq m’boni nervoz. Thash, zaherë najkush ka marrë naj punëtori e asishne. Ka qenë shumë punë e rondë, shumë punë e vështirë.

Mandej kemi pasë shumë objekte shumë përgjegjësi. E ki n’shpi tonde edhe tutesh fminë, po t’vrahet po t’asi... kemi punu’ shumë. N’tona vendet kom pasë sukses, veç kom punu me sinqeritetin ma t’madh edhe kom qenë e angazhume seriozisht.

Kaltrina Krasniqi: Kur osht’ hapë çerdhja e parë n’Kosovë?

Myrvet Limani: Une nuk kom qenë n’çerdhet e para këtu, une kom qenë n’Prizren, mandej vonë kom punu nëpër shkolla. Çerdhja m’ka ardhë rasisht, m’ofrojshin me shku nëpër shkollat fillore si drejtoreshë, une nuk dojsa për arsye se thojsha i kom tre djem ma mirë ta kenë shpinë të ngrohtë, le t’vijne me hongër bukë n’shpi sesa me hongër nëpër rrugë. Kështu që edhe mandej kom punu nëpër konferenca kom qenë kështu.

Vjehrrën e kom pasë, ka qenë një gru e mirë e Prizrenit, plakë ka qenë. Ajo veç u falke gjithë ditën, ka qenë nona e Xhahitit, e mirë. E, thojsha edhe shpinë ta kom, kur e ki... edhe burrin e ki t’qetë kur e ka shpinë n’rregull. Nëse s’e ka shpinë n’rregull edhe burri ikë prej shpisë. Une qato i kom pasë detyrat e mija. Veç kom punu, s’kom metë pa punu, krejt kom punu.

Kaltrina Krasniqi: Ku keni qenë n’luftën e fundit n’vitin 1999?

Myrvete Limani: A ju kallxova une?

Kaltrina Krasniqi: Jo, kemi folë për vitin ‘90, ‘89... ‘81, e tash...

Myrvete Limani: A ju kallxova që kemi qenë gjatë Luftës Nacional Çlirimtare kemi qenë në malësi të Shipnisë. Ajo osht’ shumë me randsi.

Kaltrina Krasniqi: A po na tregoni?

Myrvete Limani: Po ju kallxoj qato përpara, a pe sheh që pasna harru. Akcionet tash Fadili që ishte komandant, akcionet që i bojke, na që ishim n’Kosovë n’Gjakovë, shpija jonë, na ishim njerëz që na kishin n’dorë. Ai me bo një akcion, neve që na varën vllaun, e burgosën tjetrin, e burgosën babën, na kallën shpinë, krejt na bonë. E fatkeqësija ma e madhe, kur na kallën shpinë, atëhere lypshim shpi me qira, mahalla u tutke me na lshu shpinë. Pse u tutke? Se thojke, “Një aksion që ju bojnë juve, neve na bjen hise edhe mahallës, damtohet edhe mahalla”. Kështu që, na kemi qenë shumë n’rrezik, krejt që kemi qenë n’Gjakovë baba i vjetër, nona edhe ajo bajegi e vjetër, na të ndryshëm. Vllau ishte kryesori edhe u deshke, ata kon e kishin peng, na ishim peng aty.

Shpinë na kallën me 1 prill '43-shin. Kërkush në mahallë nuk na dojke neve, merre me mend. U tutshin njerëzit se, “Vijnë me ju damtu juve e na bjen hise edhe kojshisë e karshisë”. E kemi pasë, mandej dajën e kemi pasë, ai na ka majtë. E daja, n’shpi t’dajës kemi nejtë një kohë shumë gjatë aty. Edhe Fadili t’u e pa që osht’ shumë rrezik thojke, “Unë kurrëfar aksionu s’un po boj. Ju jeni peng, juve ju vrasin, juve ju asi...” Na çoi letër, babën e kishim t’internumë, i çoi nonës teme letër tha, “Merri çikat, e merri këta dy vllaznit ma t’vogjël” që i kom pasë Eminin edhe Skenderin, “hajdeni me partizanët”. U organizunë këtu partizanët, shkojmë na n’malësi t’Shipnisë në Dushaj. Aty na, na caktunë një shpi, kemi nejtë n’Dushaj deri sa osht’ maru lufta.

Atëhere neve na qiti këtu Lidhja Partizane që kemi qenë t’Gjakovës, na qitën tinëz qysh thojnë n’kufi me kalu. Qysh e kalumë, e kalumë diqysh edhe dulëm n’malësinë. E kalumë Tropojën e himë mrena në malësinë e Shipnisë. Aty na caktunë n’Dushaj një familje shumë e mirë, edhe ajo e kish marrë përsipër me na ruajtë neve. Aty jetonte ni partizan me ne, Zenel Ahmeti ka qenë ai. Ai ka qenë me grunë edhe tri çikat, t’rritun i ka pasë. Edhe gjithë natën vijshin edhe fshatarët e katundit edhe rrijshin n’shpi t’atij për me na ruajtë neve. Deri sa ka maru’ Lufta e Dytë Botnore me 9 maj që osht’ çliru, deri atëherë na kemi qenë n’Dushaj. Prej atjehit kemi ardhë n’Tropojë. N’Tropojë kemi qenë n’shpinë e Spahisë gjakovarë, ka pasë dyqanin edhe aty kemi nejtë asi. E me 9 osht’ çliru Gjakova.

Kjo motra jeme ka qenë... se ajo shkoi partizane une s’kom mujtë se unë kom qenë e vogël, s’ëm kanë marrë. Unë me dy vllaznit e mij edhe me nonën teme kom qenë n’Dushaj, kemi nejtë atje. Kemi jetu disa mujë, s’po m’kujtohet tash mujtë, mos t’flas përmensh krejt se unë kom qenë fmi. E mandej kthehemi me 9 osht çliru Gjakova po m’duket, shtator s’di, kom harru’ këto datat tash, veç çlirimi i Gjakovës. E kjo shkon partizane, motra që ish ma e madhe e jemja Nexhmija, Nexhmije e ka pasë emnin. Ajo në t’vërtetë ka qenë e martume n’Pejë masnej. E qështu... tek mandej kemi ardhë na.

Baba ka ardhë vonë, e kanë lshu prej kampit nazist të Zvicrës, ato tek ma vonë e kanë lshu. Qështu kemi pasë një jetë mos vetë, një jetë...

Kaltrina Krasniqi: A t’flasim tash për luftën e fundit, për vitin 1999?

Myrvete Limani: Për vitin 1999, Fadilin e kom ni vet me veshët e mi thojke, “Veç jom plakë, s’e i kisha veshë edhe njihere opangat e kisha dalë”. Shumë i vijke rondë që s’mujke me ndihmu. Këtu me ndihma kështu materiale diqysh veç kemi majtë shumë shpresa të mdhaja qi do t’fitohet. Mirëpo atëhere fillunë na erdhën qitu, prej kojshisë, kojshinë e kemi pasë serb. E kapërcynë murin qitu ku jonë trandofillet edhe na dulën shtatë-tetë vetë me pushkë n’shpi mrena. E dijshin kush jemi, e na e kemi pasë bo vendin n’podrum me fjetë. Patëm çu sende jambolia e kështu me fjetë n’podrum se gjujshin atëhere edhe me bombe edhe kemi mujtë... E mandej kur e pamë që u rrezikum shumë, ishim t’parrezikum. Atëhere këto çikat kanë qenë t’vogla, i mushën çantat e vogla t’shkollës me tesha për ndërrim, e lamë shpinë krejt. Shpija kurrëfar’ vlefte s’ishte, shpija e ndërtume e re.

Na murë Iliri na çoi, atë djaln e kom pasë në banesë. Shkojmë me marrë Dukagjinin, dalin kojshitë thojnë, “Dukagjini nuk osht”. Ato e kishin pasë marë një natë përpara e kishin pas qitë n’kolonë me qitë n’Shipni. Shkojmë na, kur vijmë te stacioni qe - policia. Flasin me Ilirin, asi ia marrin kerrin. I thojnë, “Na jep ti kerrin, kur t’kryhet lufta ta kthejmë kerrin”. Ia dha letrat, ia dha kerrin, hypëm n’tren shkumë n’Shipni.

Kur shkumë n’Shipni, ka qenë mraz dimën, borë kijamet. Une kom qenë shumë e smutë. Edhe, mandej kemi nejtë qashtu në t’ftoftë. Këta t’Maqedonisë nuk na pranunë n’atë sheshin. Me mijëra njerëz ka pasë, lloq, baltë, ftoftë, kijamet. Une mo, n’lloq kemi fletë e kemi nejtë. I bijshin do najllona, me qindra shqiptarë ka pasë, me qindra. Dikush diske, kush s’mujke me qëndru, jonë dekë shumë veta. Maqedonët nuk lijsin me shku n’Shkup e asi. Ma n’fund, një koleg e Ilirit e kishte shpinë n’Maqedoni. Menxi që na lshunë, shkumë në shpi t’atijna, na pranoi. Kemi nejtë dy mujë, noshta ma tepër. Edhe qështu kemi kalu. Ajo familje ke e mirë, Iliri e ka pasë koleg atë shokun, profesor n’fakulltet që kanë punu bashkë. Edhe emrat tash s’po m’kujtohen. Po një familje e mirë, na kanë kqyrë deri sa u çliru edhe Kosova, mandej erdhëm këtu.

Kur vijmë këtu, e kqyrshin përmes satelitit, thojshin shpinë nuk iu kanë kallë. E na shpëtoi shpija, erdhëm n’qëtë shpi që kemi qenë përpara. E n’Gjakovë kishin pasë bo kërdi, veç nuk ka prej familjes jonë nuk u vra kërkush. N’Gjakovë krejt me djem e familje, krejt t’shpisë i kemi ndigju emnat e atyne familjeve, n’Gjakovë kishin pas bo kërdi shkijet. E qështu... çka me ju kallxu?

Hajde u çlirimë, kur u çlirimë çka fitumë? Kërkush s’pe njëf Kosovën, falë Amerikës, edhe këta, se po me metë ma zi se që kemi qenë. Na ndihmunë amerikanët, na ndihmunë ata. Erdhëm, tash s’e di a na kanë ndihmu apet, po na kanë ndihmu’ edhe na kanë shëmtu’. Nuk po jonë t’knaqun. Tash n’vend se me kqyrë vendin, tash njerëzit pa punë po ikin prej Kosovës, s’po kanë bukë me hongër. Çka me ju kallxu, s’kom kurgjo çka ju kallxu. T’paknaqun, e s’po jonë n’gjendje një qeveri me bo siç duhet. Po përлахen nërmjet veti {përplas duart}. Si me marrë unë qitash me ju shajtë juve, e mandej miqësia ku metë, mirësia ku metë. Shaj... s’kom çka me folë, s’kom çka me folë, mos m’pytni shumë se mund t’kem shprehje negative.

[Intervistuesja e pyetë për ëndrrat që ka e intervistuesja ka pasë si e re, për ato qëllime që i janë realizua dhe si ndihet sot]

Pa marrë parasysh që ndigjutë edhe që kom përjetu edhe luftat edhe krejt, edhe vujtjet që kemi pasë, por unë fundin jom shumë e knaqun. Familjën teme e kom pasë shumë t’shnoshë. Familjen e babës edhe ku jom rritë edhe ma shnosh. Prandej, krejt i kom kujtime t’mira t’shkëlqyshme, e jom krenare edhe me ballhapë lavdohna. Shpija jonë e përmendun edhe e babës, edhe e burrit tem. Familja e nderushme osht’ kjo e Prizrenit. Jetë t’shkëlqyshme kom kalu, kurrë s’kisha dashtë ma mirë. Lufta osht’ luftë, ajo t’çon nëpër rrugët e veta, edhe i ka dhimjet e veta. Rrugë jetësore që kom përjetu edhe te baba edhe te burri, unë kom pasë shumë fat. Po edhe jom përpjekë me rujtë këtë hap se edhe unë kom kontribu.

Nuk besoj që n’jetë kom bo naj gabim, nuk besoj. Kom qenë e nderume, kushdo që m’ka njoftë e kushdo që ka folë me mu, e nderume, e respektume në t’gjitha kohnat. Jom krenare për jetën teme për familjen,

familjet e mia, për babën, për nanën, për vllaznit, motrat, krejt. Jemi t'papërlyem. Mu m'pëlqen një jetë e hapët, por e kontrollume. Mu... nuk kom qef kur e shoh rininë t'shkapërderdhun, ajo duhet me kenë e kompletume, e afërt me normat njerëzore, ajo m'pëlqen. Mu disa norma nuk m'pëlqejnë që janë t'lira t'pakontrollume, n'kuptim t'qasaj. Le t'urrnojnë le t'del dikush t'na qet një lak, le t'urrnojnë. Tona t'mirat... jom shumë krenare për jetën teme, për familjen e burrit tem, për fmitë e mij e mos me folë për krejt familjen babës tem e krejt akrebave. Nuk kemi familje qëkaq një lak që e kanë, me gra me nuse me t'gjitha t'mira. Jom shumë, shumë krenare. Barëm nashta po m'vjen keq që po thomë se shyqyr që ka edhe shumë familje sikur unë, veç osht' e përsosun, osht' e përsosun.

Kaltrina Krasniqi: Falemnderit.

Myrvete Limani: Kemi pasë shumë fat, se mjafton një me dalë me ta prishë rregullin, shumë fat. Edhe n'punë kam qenë e lavdume edhe une edhe fmitë krejt, edhe me msime tonë janë t'shkelqyshëm. Ka qenë ky djali që m'ka dekë oh Zot, fenomen i posaçëm. Edhe Iliri edhe Dukagjinin, nipat, mesat, nashta mos po m'bjën mu lavdu shumë, veç urroni edhe vetni. Qe edhe i njifni pjesën e çikave këtu, jemi me t'vërtetë krenarë. Une jom faqebardhë. Qiky shnetë n'fund s'mu ka deshtë qështu, po u bo edhe kjo, s'kom çka i boj. Deri para një vjeti kam qenë si një lis, lis. Nime mosha erdh, po një moshë e kontrollume, një moshë me rregullat e veta, me memorie me t'gjitha me punë, krejt normal.

Edhe, interesant osht' puna jeme, barëm këta tonë e kanë habi, gjanat t'fminisë që gjashtë-shtatë vjet, i maj n'mend. Edhe kërkush me mu direkt s'ka folë, "Maj n'mend qëto!", po i kom ndëgju' njëherë ato kanë fletë n'trunin tem. Edhe janë t'habitun, po qetash që e pata qetë rrëzim, m'ka dëmtu, m'ka dëmtu, m'ka dëmtu. T'kisha me kalu qetë edhe qikjo kohë që m'ka metë, atëherë do t'ishte lavdatë e përsosun. Mirë, mirë, jom krenare për jetën teme, për familjen teme edhe për t'gjithë familjet e gjera që kom pasë. E keni pasë rast me ndigju, s'ka dikush prej nesh qoftë edhe kushëri i largët që ka bo gabime. E qështu e kemi pasë fatin, qështu osht' rujtë ajo origjinë, qështu. Mandej te Xhahiti, familje e njoftun e Prizrenit. Edhe une i kom pranë se na pak dallojmë Gjakova-Prizreni, ata flasin turqë, na shqip. Çfarë, çfarë, familje e përsosun.

Kaltrina Krasniqi: Falemnderit.